



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE
BORDI

VENDIM

Nr. 150, datë 24.07.2019

PËR
MARRJEN E MASAVE KORRIGJUESE NDAJ BYROSË SHQIPTARE TË SIGURIMIT

Në bazë dhe për zbatim të nenit 13, 14, pika 23 dhe nenit 32 të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare” dhe Ligjit nr. 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare,

K O N S T A T O I S E :

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare në përputhje me kërkesat e neneve 2 dhe 19 të Ligjit 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, nenit 45, të Ligjit 10076, datë 12.02.2009 “Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit”, në vijim të procesit të ndjekjes së Fondit të Kompensimit si dhe në zbatim të vendimeve të Bordit nr. 260, datë 28.12.2018 dhe nr. 118, datë 06.06.2019, konstaton se:

BSHS me shkresën nr. 4585 prot, datë 10.07.2019, ka depozituar raportimin periodik për periudhën janar – qershor 2019. Format i raportimit nuk është në përputhje me kërkesat e Autoritetit sipas vendimit të Bordit nr. 118, datë 06.06.2016, si përse i përket vlerës së detyrimit të Fondit të Kompensimit ashtu dhe pagesave të kryera nga shoqëritë.

Pagesa në total gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2019, për detyrime të Fondit të Kompensimit janë në vlerën 323,204,438 lekë, ndërsa duke përfshirë dhe marrëveshjet niveli i pagesave është rreth 76% të detyrimit të 6-mujorit të parë të vitit 2019.

Përse i përket zbatimit të vendimit të Bordit nr. 118, datë 06.06.2019, si dhe inspektimet e kryera pranë BSHS-së, rezulton se:

Byroja Shqiptare e Sigurimit me shkresën nr. 4581 prot. datë 10.07.2019, ka depozituar informacion lidhur me zbatimin e vendimit të mësipërm, ku informon se ka vijuar shpërndarjen e praktikave objekt i Fondit të Kompensimit dhe aktualisht janë shpërndarë vetëm 6 praktika, si dhe në mbledhjen e APA të BSHS-së datë 25.06.2019 është vendosur se do të analizohen pagesat e kryera deri më 30.06.2019, për të konkluduar nëse ka nevojë për shtesë të Fondit të Kompensimit.

Lidhur me afatin e përcaktuar sipas pikës 1.1 të këtij vendimi, AMF ka kryer inspektim më datë 24.06.2019, pranë BSHS-së me shkresën nr.1919/2 prot., datë 21.06.2019, me objekt verifikimin mbi zbatimin e pikës 1.1, të vendimit të Bordit të Autoritetit nr. 118, datë 06.06.2019, lidhur me shpërndarjen e praktikave të përfunduara të detyrueshme për tu ekzekutuar te shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së.

Lidhur me disa ankesa të depozituara në AMF janë kryer disa inspektime tematike në vend te Byroja Shqiptare e Sigurimit si më poshtë nga ku rezultoi se Byroja nuk ka bërë shpërndarjen e praktikave dhe nuk ka autorizuar asnjë shoqëri sigurimi për pagesë, në shkëlqje të nenit 6, pika 1, të Rregullores nr. 36, datë 21.03.2012, e ndryshuar, praktikë të cilën duhet t'ia kishte kaluar Asamblesë së Përgjithshme të Anëtarëve për shpërndarje dhe BSHS të lëshonte autorizimin për pagesë.

Duke qenë se ka pasur një dakordësi për ngjarjet deri 31.12.2013, është marrë vendimi i APA nr. 09, datë 07.03.2019, që të rishpërndahet për të gjitha shoqëritë e sigurimit në vitin 2019, vlerën prej 213,599,369 lekë, (që i përket vendimeve gjyqësore të cilat janë fituara nga shoqëritë e sigurimit Eurosig sh.a. (FK 2015-2016), Ansig sh.a. (FK 2015-2016-2017) dhe Albsig sh.a. (FK 2018), aktualisht kërkojnë të tërhiqen nga kjo marrëveshje.

Për sa më sipër Bordi i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare,

V E N D O S I:

- 1. Shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së të plotësojnë detyrimin përkatës të Fondit të Kompensimit.**
- 2. Byroja Shqiptare e Sigurimit të kryejë shpërndarjen e praktikave të përfunduara, të detyrueshme për tu ekzekutuar, te shoqëritë e sigurimit anëtare të BSHS-së, duke njoftuar Autoritetin deri më datë 15 gusht 2019, në të kundër Autoriteti të bëjë shpërndarjen e praktikave të përfunduara, sipas pikës 10.4, neni 10, të Rregullores nr. 119, datë 06.06.2019 “Mbi administrimin e Fondit të Kompensimit”.**
- 3. BSHS të analizojë situatën e Fondit të Kompensimit për të vendosur nëse ka nevojë për shtesë të Fondit të Kompensimit për vitin 2019.**
- 4. Për moszbatim të vendimeve të Bordit të Autoritetit, bazuar në nenin 32, të Ligjit nr. 9572, datë 03.07.2006 “Për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare”, i ndryshuar, paralajmërohet për shkarkim Drejtori Ekzekutiv i BSHS-së.**
- 5. Ngarkohen Departamentet përkatëse për njoftimet në zbatim të këtij vendimi.**

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

ANËTAR
Deniz DERALLA

DREJTOR I PËRGJITHSHËM EKZEKUTIV
Ervin KOÇI